



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr. prot
5302/6

Tiranë më, 24/12 /2018

VENDIM

NR. 38 DATË. 24/12/2018

PËR

SHTYRJEN E VENDIMIT PËR “MIRATIMIT NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE, NGA HEC BERZHITA, SUBJEKTIT “AB70-KONSTRUKSION” SH.P.K.

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar, përkatësisht të nenit 42 pika 3; neni 50, pika 2, neni 52 gërma c ; të VKM -së nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedura ve të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë object konçesioni”, neni 24, gërma “f ndryshuar me VKM nr 718 datë 12.10.2016”, me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit “**AB70-Konstruksion** ” shpk Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen,

KONSTATOI SE,

Nga diskutimet e anëtarëve të KBU u kërkua saktësimi Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale të Mjedisit drejtuar Prefektit të Qarkut Tiranë, DRM ka dhënë opinion negativ për “Hec Bërzhita”, pasi nuk ka aplikuar pranë institucioneve përkatëse. Anëtarët e Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen kërkuan mendimin anëtarit të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen, përfaqësues i Drejtorisë Rajonale, në mbledhjet e që do vijojnë për një vendimarrje sa më korrekte, pasi nuk ishte prezent në këtë mbledhje.

Për këto arsye, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm - Erzen,

V E N D O S I

1.Shtyrjen e vendimit për "Miratimin në parim për përdorim të burimit ujor nga Hec Bërzhita të subjektit "AB70-KONSTRUKSION " sh.p.k." me administrator Z.Arben Banushaj, për përdorim burimit ujor në rrjedhën e sipërme të lumit Erzen, në fshatin Bërzhitë dhe Godinë centrali pranë fshatit Qeha Bashkia Tiranë,qarku Tiranë me këto të dhëna :

- Koordinatat e veprës së marrjes X – 44 09 372 Y –45 67 680 Z- 186
- Godina e centralit me koordinata : X- 44 07 791 Y- 45 69 694 Z- 158
- Prurja mesatare: Q mes 6,460 m³/sek;
- Prurja ekologjike: Q₃₅₅= 0.499 m³/sek;
- Prurja që shkarkohet: Q_{lllog}= 7.330 m³/sek.
- Fuqia e instaluar E= 1320 KW
- Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë Q_{vaditëse}=0.200 m³/sek

2-Kjo kërkesë shtyhet për arsyet e mëposhtme:

- Të kërkohet mendimi i anëtarit të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, në mbledhjet që do të vijojnë ,.
- Të saktësohet raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3- Ngarkohet A.B.U. Ishëm- Erzen për zbatimin e ketij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUNI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

